



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 2, datë 30.12.2015

PËR

MIRATIMIN E KUFIRIT TË ZONAVE TË REJA INFORMALE DHE
RISHIKIMIN E DISA ZONAVE EKZISTUESE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, nenit 11 të Ligjit Nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, VKM Nr. 671, datë 29.07.2015 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, VKM Nr. 589 datë 10.09.2014 “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren të ndërtimeve/shtesave pa leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale”, si dhe VKM Nr. 1097, datë 28.12.2015 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave / Ndërtimeve Informale (ALUIZNI), Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e kufirit për 7 zona informale të Qarkut Vlorë, Zona Informale Nr. 2-8, Njësia Administrative Vlorë, Bashkia Vlorë, miratuar me vendim të Këshillit Teknik të ALUIZNI-t Nr. 1, datë 02.09.2015, me sipërfaqje 441.58 ha dhe rishikimin e kufirit të Zonës Informale ekzistuese Nr. 2, Rajoni Nr. 1, të Bashkisë Vlorë, miratuar me Vendim Nr. 1/4, datë 18.04.2008 të KRRTRSH-së, sipas hartës bashkëlidhur.
2. Miratimin e kufirit për 58 zona informale të Qarkut Tiranë, miratuar me Vendim Nr. 2, datë 07.12.2015 të Këshillit Teknik të ALUIZNI-t, me sipërfaqje 9518.14 ha dhe rishikimin e kufirit për 54 zona/vendbanime Informale ekzistuese, sipas Aneksit 1 dhe hartës bashkëlidhur.
3. Miratimin e kufirit për 12 zona informale të Qarkut Lezhë, miratuar me Vendim Nr. 2, datë 07.12.2015 të Këshillit Teknik të ALUIZNI-t, me sipërfaqje 466.23 ha sipas Aneksit 2 dhe hartës bashkëlidhur.
4. Miratimin e kufirit për 6 zona informale të Qarkut Shkodër, miratuar me Vendim Nr. 2, datë 07.12.2015 të Këshillit Teknik të ALUIZNI-t, me sipërfaqje 319.29 ha dhe rishikimin e kufirit për vendbanimin informal, i miratuar me Vendim Nr. 1/4, datë 04.10.2007 të KRRTRSH-së, sipas Aneksit 3 dhe hartës bashkëlidhur.
5. Miratimin e kufirit për 16 zona informale të Qarkut Korçë, miratuar me Vendim Nr. 2, datë 07.12.2015 të Këshillit Teknik të ALUIZNI-t, me sipërfaqje 543.33 ha dhe rishikimin e kufirit për 4 zona dhe vendbanime Informale, i miratuar me Vendim Nr. 1/8, datë 26.07.2007 dhe Nr. 1/5, datë 18.04.2008 të KRRTRSH-së, sipas Aneksit 4 dhe hartës

6. Miratimin e kufirit për 18 zona informale të Qarkut Elbasan, miratuar me Vendim Nr. 2, datë 07.12.2015 të Këshillit Teknik të ALUIZNI-t, me 1480,91 ha dhe rishikimin e kufirit për 7 zona dhe vendbanime informale, Qarku Elbasan, të miratuar me Vendim Nr. 4/4, datë 17.01.2008 dhe Nr. 1/6, datë 26.10.2007 të KRRTRSH-së, sipas Aneksit 5 dhe hartës bashkëlidhur.
7. Miratimin e kufirit për 17 zona informale të Qarkut Durrës, miratuar me Vendim Nr. 2, datë 07.12.2015 të Këshillit Teknik të ALUIZNI-t, me sipërfaqje 4940.75 ha dhe rishikimin e kufirit për 2 zona informale, i miratuar me Vendim Nr. 1/6, datë 18.04.2008 të KRRTRSH-së, sipas Aneksit 6 dhe hartës bashkëlidhur.
8. Miratimin e kufirit për 6 zona informale të Qarkut Berat, miratuar me Vendim Nr. 2, datë 07.12.2015 të Këshillit Teknik të ALUIZNI-t, me sipërfaqje 168.11 ha sipas Aneksit 7 dhe hartës bashkëlidhur.
9. Miratimin e kufirit për 68 zona informale të Qarkut Fier, miratuar me Vendim Nr. 2, datë 07.12.2015 të Këshillit Teknik të ALUIZNI-t, me sipërfaqje 1952.1 ha sipas Aneksit 8 dhe hartës bashkëlidhur.
10. Miratimin e kufirit për 5 zona informale të Qarkut Dibër, miratuar me Vendim Nr. 2, datë 07.12.2015 të Këshillit Teknik të ALUIZNI-t, me sipërfaqje 490 ha sipas Aneksit 9 dhe hartës bashkëlidhur.
11. Miratimin e kufirit për 4 zona informale të Qarkut Kukës, miratuar me Vendim Nr. 2, datë 07.12.2015 të Këshillit Teknik të ALUIZNI-t, me sipërfaqje 239.6 ha, sipas Aneksit 10 dhe hartës bashkëlidhur.
12. Destinacioni i hapësirave të pazëna nga parcelat e ndërtimeve informale brenda vijave kufizuese të zonave informale, të jetë sipas përcaktimeve të planeve të përgjithshme dhe të detajuara vendore dhe në përputhje me projektet e infrastrukturës publike. Brenda zonave informale, për parcelat e zëna me ndërtime pa leje, të realizohet ndryshimi i rregjimit të tokës në tokë truall me dhënien e lejes së legalizimit.
13. Ngarkohet Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave / Ndërtimeve Informale dhe të gjitha Autoritetet e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
14. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI


EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA



DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT